



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 271/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.05.2019 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Shendelli” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-07104-02-08-2019, me objekt: “*Rruga (Ibrahim Rugova+Mark Tirta+Mehdi Frasheri+Mit’hat Frasheri)*”, me fond limit 44.081.461 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 13.03.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamez.”
- Ankimues:** “Shendelli” sh.p.k
L. “Kastriot”, Rr. “Andon Profka”, “2 Kullat”, Fier
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kamez
“Bulevardi Blu” nr.492 Kamez Tiranë
- Subjekte të Interesuar:** “Euro-Alb” sh.p.k
L. Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15, Bulqizë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V e r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.02.2019 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-07104-02-08-2019, me objekt: “*Rruga (Ibrahim Rugova+Mark Tirta+Mehdi Frasheri+Mit’hat Frasheri)*”, me fond limit 44.081.461 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 13.03.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamez.

II.2. Në datën 01.04.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

1. “Shamo-Construction” sh.p.k	35.258.990,00 lekë, skualifikuar
2. “Kacdedja”sh.p.k	39.589.280,00 lekë, skualifikuar
3. “Shendelli” sh.p.k	39.740.600,00 lekë, skualifikuar
4. “Bami” sh.p.k	40.009.406,50 lekë, skualifikuar
5. “Arifaj” sh.p.k	40.537.330,00 lekë, skualifikuar
6. “Be-Is” sh.p.k	40.703.045,00 lekë, skualifikuar
7. “Lala” sh.p.k	40.954.373,00 lekë, skualifikuar
8. “Liqeni VII” sh.p.k	41.478.590,00 lekë, skualifikuar
9. “Euro-Alb” sh.p.k	42.310.091,00 lekë, kualifikuar
10. “Ndërtimi” sh.p.k	43.210.140,00 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik “Shendelli” sh.p.k është skualifikuar me argumentin se:

1. *Mjetet e marra me qira nga "Jody Kompany" janë paraqitur edhe nga subjekti tjetër "Lala" shpk, për këto arsye të dy subjektet skualifikohen nga procedura. Po ashtu ka mjete të marra me qira nga Aliko Nderim të cilat janë dhënë me qira edhe një subjekti tjetër.*
2. *Nuk është paraqitur mjek fare, asnjë dokument.*

Njëri nga anëtarët e KVO-së gjithashtu pretendon se: *“Formulari i ofertës është i shprehur vetëm me shifra dhe jo me fjale sic e kërkon formati në dst.”*

II.3. Në datën 04.04.2019 operatori ekonomik “Shendelli” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit.

II.5. Nëpërmjet shkresës Nr.1831/1 Prot., datë 05.04.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, si më poshtë vijon:

“Në përgjigje të shkresës suaj nr. 38 prot., datë 02.04.2019, protokolluar pranë Bashkisë Kamëz me nr. 1772 prot., datë 04.04.2019, ju bëjmë me dije se, pasi u mor në shqyrtim ankesa e paraqitur nga ana juaj dhe pretendimet tuaja mbi arsyet e skualifikimit, u konstatua se formulari i ofertës nuk është kërkuar në formën e kërkuar nga ligji dhe përcaktimet që bënë DST. Gjithashtu përvoja i përket mjeteve të marra me qira nga “Jody Kompany” rezulton se këto mjete janë paraqitur brenda së njëjtës periudhë edhe nga subjekti “Lala” sh.p.k, i cili gjithashtu është ofertues pranë Bashkisë Kamëz në procedurat e prokurimit publik. Nuk mund të merren me qira të njëjtat mjete nga subjekte të ndryshme, në periudhë të njëjtë kohore. Sa më sipër, autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz nuk e merr në konsideratë ankesën tuaj.”

II.6. Në datën 10.04.2019 operatori ekonomik “Shendelli” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.7. Në datën 18.04.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 654/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 2025/1 prot., datë 17.04.2019, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes “Shendelli” sh.p.k *“përvoja i përket mjeteve të marra me qira nga “Jody Kompany” rezulton se këto mjete janë paraqitur brenda së njëjtës periudhë edhe nga subjekti “Lala” sh.p.k, i cili gjithashtu është ofertues pranë Bashkisë Kamëz në*

procedurat e prokurimit publik dhe nuk mund të merren me qira të njëjtat mjete nga subjekte të ndryshme, në periudhë të njëjtë kohore”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 11, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është parashikuar plotësimi i kërkesës si vijon:

“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës (10-15 ton)	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë me kapacitet mbajtës (3.5 -5 ton)	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhirë	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinç	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul me kompresor	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul me vibrim	1 copë	Pronësi ose me qera
Elektrosaldatriçe	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobitumatriçe	1 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 30 (tridhjetë) copë;
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 4 katër) copë;
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 3 (tre) copë;
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 4 (katër) copë;
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 (pesë) copë.

Pajisjet e mesiperme te provohen me dorzimin e faturave te blerjes, akt cdoganimi ose kontrateve te mara me qera te pajisjeve

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b)leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a)dokumentit qe verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes.

- b) Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatëse (e vlefshme).
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamez. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).”

III.1.2. Në shtojcën 10 “Mbi disponimin e makinerive”, pjesë e dokumentave të tenderit, është përcaktuar:

Shtojca 10

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]
MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE

Operatori ekonomik: _____

Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt: _____

<i>Në pronësi</i>				
<i>Lloji i Mjetit</i>	<i>Targa</i>	<i>Nr. Lejes qarkullimit</i>	<i>Nr. Shasisë</i>	<i>Të tjera</i>
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

<i>Me qera</i>					
<i>Lloji i Mjetit</i>	<i>Targa e mjetit</i>	<i>Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit</i>	<i>Nr. Shasisë së mjetit</i>	<i>Nr. Kont së qerasë (noterisë)</i>	<i>Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)</i>
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- *shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.*

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë. [...].

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Shendelli” sh.p.k, përsa i përket arsyes së skualifikimit, rezulton se është paraqitur si vijon:

1. *Kontratë Qeraje nr.1019 Rep nr.308 Kol datë 28.04.2018 lidhur ndërmjet Shoqërisë “Jody Kompany” sh.p.k në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë “Shendelli” sh.p.k në cilësinë e qiramarësit për dhënie në përdorim palës qiramarrëse për një afat 10 vjecar të mjeteve asfaltoshtruese, bitumatrice, grejder, fadrom, frezë+presë asfalti, instrument nivelimi, rul me vibrim, rul vibrimi Bitelli.*
2. *Kontratë Qeraje nr.1084 Rep nr.508 Kol datë 27.06.2016 lidhur ndërmjet Shoqërisë “Jody Kompany” sh.p.k në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë “Shendelli” sh.p.k në cilësinë e qiramarësit për dhënie në përdorim palës qiramarrëse për një afat 10 vjecar të mjeteve betonierë kantieri, fadrom bobcat, mini eskavator, dy kamionë, eskavator+cekic, skrep, APV JCB.*
3. *Kontratë Qiraje nr.399 Rep nr.154 Kol datë 28.02.2018 lidhur ndërmjet Shoqërisë “Jody Kompany” sh.p.k në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë “Shendelli” sh.p.k në cilësinë e qiramarësit për dhënie në përdorim palës qiramarrëse për një afat 10 vjecar të mjeteve kamion (SR4937B) dhe autobot (AA387PA).*

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

III.1.5. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.6. Në nenin 26, pika 8, gërma “c”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: c) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik “Shendelli” sh.p.k se *mjetet e marra me qira nga “Jody Kompany” janë paraqitur brenda së njëjtës periudhë edhe nga subjekti “Lala” sh.p.k, i cili gjithashtu është ofertues pranë Bashkisë Kamëz në procedurat e prokurimit publik dhe nuk mund të merren me qira të njëjtat mjete nga subjekte të ndryshme, në periudhë të njëjtë kohore*, nuk tjetërson kontratat e lidhura mes subjektit qeradhënës dhe shoqërisë “Shendelli” sh.p.k, aq më pak të shërbejë si shkak skualifikimi, pasi kjo shoqëri ka detyrimin ligjor të dëshmojë se disponon mjetet e kërkuara në kriterin e vecantë të kualifikimit me anë të kontratave të qerave të lidhura rregullisht para noterit. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor nuk mund të paragjykojë kontratat e qerave të paraqitura nga ana e operatorit ekonomik ankimues, përse kohë që ato garantojnë vullnetin e lirë të palëve mbi disponimin e mjeteve.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e punimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik të vërtetohet se gëzon dhe disponon kapacitetet e duhura në lidhje me mjetet për realizimin me sukses të kontratës, fakt ky që duhet vërtetuar nëpërmjet dokumentacionit përkatës, në përputhje me kriteret kualifikuese.

Sqarojmë se, për autoritetin kontraktor është e domosdoshme që një operator ekonomik pjesëmarrës të përmbushë kriteret e përcaktuara nga ai në dokumentat e tenderit duke vërtetuar se disponon kapacitetet ekonomike, financiare, teknike profesionale me dokumentacionin e paraqitur, dhe nuk duhet të jetë qëllim në vetvete skualifikimi i tij duke gjykuar dhe shqyrtuar këtë dokumentacion në mënyrë të njëanshme e sipërfaqësore.

Sa më sipër pretendimi i shoqërisë “Shendelli” sh.p.k qëndron.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Shendelli” sh.p.k se: “*Nuk është paraqitur mjek fare, asnjë dokument*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 4 dhe 6, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është parashikuar si vijon:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

“Një punësim mesatar i të paktën 48 (dyzet e tetë) personave, për periudhën Janar 2018 - Janar 2019 të vërtetuar me;

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Janar 2018 - Janar 2019.*
- b. List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Janar 2018 - Janar 2019 shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.”*

“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesa, 1 (një) mjek të përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.(Në mbështetje të VKM Nr. 692 datë 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, Neni 12/1 Operatorët ekonomik pjesmarrës që kanë të punësuar më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme.)”

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Shendelli” sh.p.k., në përmbushje të kriterit për punonjës me profesionin mjek, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Kontratën e punës nr.rep. 9099 nr.kol. 787, datë 10.10.2016 ndërmjet punëdhënësit shoqërisë “Shendelli” sh.p.k. dhe punëmarrësit Z. D.Y, me profesion mjek.
- Diplomë nr.5020-B, “Mjekësi E Përgjithshme”, në emër të z. D.Y, lëshuar në datë 12.07.1984 nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë.
- Licencë për Ushtrimin Individual të Profesionit për Mjekë, datë 14.10.2015 në emër të Dr. D.Y.
- Cv e Z. D.Y.
- Listëpagesat e shoqërisë “Shendelli” sh.p.k. për periudhën Janar 2018-Shtator 2019, ku figuron i punësuar punonjësi Z. D.Y.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*

III.2.4. Në nenin 26 *“Kontratat për punë publike”*, pika 5, e VKM nr. 914 datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar parashikohet se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.*

III.2.5. Në nenin 26, pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, përcaktohet: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt I kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose*
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*
- c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushurkontratën.*
- ç)Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit. [...]*

III.2.6. Në VKM nr. 742, datë 6.11.2003 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.692, datë 13.12.2001 të Këshillit të Ministrave “Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë”* është përcaktuar:

“2/1. Punëdhënësi siguron funksionimin e shërbimit mjekësor, nëpërmjet mjekut të ndërmarrjes, në të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari prodhuese, private ose shtetërore, vendase ose të huaja, juridike ose fizike.

2/2. Mjekët e ndërmarrjes pajisen me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, në përputhje me vendimin nr.500, datë 23.11.1992 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e licencave për ushtrimin e profesionit në fushën e mjekësisë, në profesion të lirë privat”, i ndryshuar.

2/3. Mjekët e ndërmarrjes merren në punë si nëpunës të ndërmarrjes dhe varen drejtpërdrejt nga punëdhënësi. Punëdhënësi e njeh mjekun me detyrat e shërbimit shëndetësor të ndërmarrjes dhe kërkon zbatimin e tyre, sipas legjislacionit të punës. Marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësit dhe mjekut të ndërmarrjes përcaktohen në bazë të kontratës së punës që lidhin palët, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

[...]

“12/1. Marrja në punë e mjekut është e detyrueshme për të gjitha subjektet, veprimtaria e të cilave klasifikohet sipas vendimeve nr.459, datë 22.7.1998 “Për substancat e rrezikshme”, nr.419, datë 4.8.2000

"Për objektet e rrezikshme" dhe nr.207, datë 9.5.2002 "Për përcaktimin e punëve të vështira ose të rrezikshme" të Këshillit të Ministrave, pavarësisht nga numri i të punësuarve.

12/2. Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të këtij vendimi, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.

12/3. Mjeku i ndërmarrjes mban përgjegjësi sipas ligjit për pasojat, që mund të vijnë nga moszbatimi i detyrave të përcaktuara sipas pikës 2/4 të këtij vendimi."

[...]"

III.2.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të kenë në stafin e tyre një mjek, vërtetuar kjo me kontratën e punës, Urdhër mjeku, diplomë dhe licencën e ushtrimit të profesionit. Gjithashtu ky i fundit duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2018 – Janar 2019.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "Shendelli" sh.p.k., në sistemin e prokurimit elektronik në përmbushje të kriterit të mësipërm, konstatohet se, shoqëria "Shendelli" sh.p.k., ka të punësuar në stafin e tij mjekun z.D.Y, duke paraqitur për këtë të fundit kontratën e punës, diplomën, licencën për ushtrimin e profesionit si dhe urdhrin e mjekut. Gjithashtu, nga verifikimi i listëpagesave të shoqërisë "Shendelli" sh.p.k. për periudhën Janar 2018 – Janar 2019, rezulton se Mjeku D.Y. figuron në këto listëpagesa për të gjithë periudhën e kërkuar. Pra ky operator ekonomik plotëson të gjitha kërkesat e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit në lidhje me mjekun.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me argumentin e dhënë nga njëri nga anëtarëve të KVO-së për shoqërinë "Shendelli" sh.p.k, i cili pretendon se: *"Formulari i ofertes është i shprehur vetem me shifra dhe jo me fjale sic e kerkon formati ne dst"*, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se ky argument nuk do të merret në shqyrtim nga ky Komision, pasi nuk është vullneti i shumicës së KVO-së, duke mospërbërë arsye skualifikimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *"Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Shendelli” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr.REF-07104-02-08-2019, me objekt: “*Rruga (Ibrahim Rugova+Mark Tirta+Mehdi Frasheri+Mit’hat Frasheri)*”, me fond limit 44.081.461 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 13.03.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamez.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Shendelli” sh.p.k, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Shendelli” shpk
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 654 Protokolli,

Datë 10.04.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

MENDIM KUNDER

Mendim kundër i anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik znj. Merita Zeqaj, në lidhje me vendimin e shumicës.

Si anëtar i KPP shpreh mendimin kundër arsyetimit të vendimit e rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, përse i përket ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Shëndelli” sh.p.k, konkretisht nuk jam dakord me arsyetimin në pikat III.1 dhe III.3, për sa i përket çështjes me

Objekt: “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Shëndelli” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-07104-02-08-2019, me objekt: “*Rruga (Ibrahim Rugova+Mark Tirta+Mehdi Frasheri+Mit’hat Frasheri)*”, me fond limit 44.081.461 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 13.03.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamez.”

I.1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Shëndelli” sh.p.k, përse i përket arsyes së skualifikimit, rezulton se është paraqitur si vijon:

4. *Kontratë Qeraje nr.1019 Rep nr.308 Kol datë 28.04.2011 lidhur ndërmjet Shoqërisë “Jody Kompany” sh.p.k në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë “Shëndelli” sh.p.k në cilësinë e qiramarësit për dhënie në përdorim palës qiramarrëse për një afat 10 vjecar të mjeteve asfaltoshtruese, bitumatrice, grejder, fadrom, frezë+presë asfalti, instrument nivelimi, rul me vibrim, rul vibrimi Bitelli.*

Në këtë kontratë është përcaktuar se: Këto mjete i japim për përdorim palës qeramarrëse për një afat 10 vjecar që fillon sot dhe përfundon në datën 28.04.2021. Qiraja mujore do të jetë sipas orëve të punës që do të kryej mjeti përkatës duke llogaritur 1000 lek/për orë pune, që do të paguhen cdo fund muaji.

5. *Kontratë Qeraje nr.1084 Rep nr.508 Kol datë 27.06.2016 lidhur ndërmjet Shoqërisë “Jody Kompany” sh.p.k në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë “Shëndelli” sh.p.k në cilësinë e qiramarësit për dhënie në përdorim palës qiramarrëse për një afat 10 vjecar të mjeteve betonierë kantieri, fadrom bobcat, mini eskavator, dy kamionë, eskavator+cekic, skrep, APV JCB.*

Në këtë kontratë është përcaktuar se: Afati I kontratës është 10 vjecar që fillon sot dhe përfundon në datën 27.06.2026.

Qiraja mujore do të jetë sipas orëve të punës që do të kryej mjeti përkatës duke llogaritur 1000 lek/për orë pune, që do të paguhen cdo fund muaji.

6. *Kontratë Qiraje nr.399 Rep nr.154 Kol datë 28.02.2018 lidhur ndërmjet Shoqërisë “Jody Kompany” sh.p.k në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë “Shëndelli” sh.p.k në cilësinë e qiramarësit për dhënie në përdorim palës qiramarrëse për një afat 10 vjecar të mjeteve kamion (SR4937B) dhe autobot (AA387PA).*

Në këtë kontratë është përcaktuar se: *Afati i kontratës është 10 vjetar që fillon sot dhe përfundon në datën 20.02.2028.*

Qiraja mujore do të jetë sipas orëve të punës që do të kryej mjeti përkatës duke llogaritur 1000 lek/për orë pune, që do të paguhen cdo fund muaji.

I.2. Në shtojcën 12 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 11, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është parashikuar plotësimi i kërkesës si vijon:

“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
<i>Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës (10-15 ton)</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamionçinë me kapacitet mbajtës (3.5 -5 ton)</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Eskavator me zinxhirë</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Eskavator me goma</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autovinç</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vibrator betoni</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobetoniere</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul me kompresor</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul me vibrim</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Elektrosaldatriçe</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobitumatriçe</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Grejder</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobot uji</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- *Kokore minimumi 30 (tridhjetë) copë;*
- *Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 4 katër) copë;*
- *Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 3 (tre) copë;*
- *Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 4 (katër) copë;*

Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 (pesë) copë.

Pajisjet e mesiperme te provohen me dorzimin e faturave te blerjes, akt cdoganimi ose kontrateve te mara me qera te pajisjeve

g) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te*

qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore te blerjes.

- h) Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).
- i) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- j) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- k) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- l) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamez. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).”

I.3. Në shtojcën 10 “Mbi disponimin e makinerive”, pjesë e dokumentave të tenderit, është përcaktuar:

Shtojca 10

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE

Operatori ekonomik: _____

Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt: _____

<i>Në pronësi</i>				
<i>Lloji i Mjetit</i>	<i>Targa</i>	<i>Nr. Lejes qarkullimit</i>	<i>Nr. Shasisë</i>	<i>Të tjera</i>
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

<i>Me qera</i>					
<i>Lloji i Mjetit</i>	<i>Targa e mjetit</i>	<i>Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit</i>	<i>Nr. Shasisë së mjetit</i>	<i>Nr. Kont së qerasë (noterisë)</i>	<i>Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)</i>
1					
2					

3					
4					
5					
6					

- *shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.*

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë. [...].

I.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

I.5. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

I.6. Në nenin 26, pika 8, gërma “c”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: c) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

I.7. Në nenin 802 të Kodit Civil përcaktohet se Qiradhënësi duhet:

- 1) t’i dorëzojë qiramarrësit sendin në kohën e caktuar dhe në gjendje që të lejojë përdorimin për të cilën palët janë marrë vesh;
- 2) të kujdeset për të mbajtur sendin në po këtë gjendje;
- 3) të garantojë gëzimin e qetë gjatë periudhës së qirasë.

I.6. Gjykoj se, arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik “Shendelli” sh.p.k se: “mjetet e marra me qira nga “Jody Kompany” janë paraqitur brenda së njëjtës periudhë edhe nga subjekti “Lala” sh.p.k, i cili gjithashtu është ofertues pranë Bashkisë Kamëz në procedurat e prokurimit publik dhe nuk mund të merren me qira të njëjtat mjete nga subjekte të ndryshme, në periudhë të njëjtë kohore”, është ligjore pasi, një mjet i marrë me qira duhet të disponohet dhe fizikisht për përdorim nga qiramarrësi në mbështetje të nenin 802 të Kodit Civil.

Gjithashtu, konstatohet qartë se të tre kontratat e sipërcituara të paraqitura nga operatori ankimues, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë nuk janë kontrata qiraje por huapërdorimi, pasi kontrata e qirasë është kalimi i disponimit të mjetit dhe jo përdorimi i tyre me orë pune.

Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit është shprehur për mjete në pronësi dhe qera, ndërkohë që nuk ka kërkuar mjete me huapërdorimi.

Gjithashtu, AK duhet të verifikojë në bilancet respective si janë pasqyruar pagesat e hua përdorimit, të paktën për kontratat që kanë filuar në datë 28.04.2011 dhe në 27.06.2016 për të dokumentuar nëse edhe këto kontrata huapërdorje janë paguar apo janë fiktive.

Sa më sipër, në kushtet kur kontratat e mjeteve të sipërcituara nuk janë kontrata qiraje por huapërdorimi dhe AK nuk ka vendosur në kriteret specifike që mjetet mund të disponohen edhe me kontrata huapërdorimi, operatori ankimues nuk provon disponimin e mjeteve.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ankimues nuk qëndron.

I.2. Lidhur me argumentin e dhënë nga njëri nga anëtarëve të KVO-së për shoqërinë “Shendelli” sh.p.k, i cili pretendon se: *“Formulari i ofertës është i shprehur vetëm me shifra dhe jo me fjale sic e kërkon formati ne dst”*, sqaroj se edhe pse nuk ka qenë vullneti i shumicës së KVO-së ky argument duhet marrë në shqyrtim, pasi shprehja me fjalë tek formulari i ofertës është detyrues me qëllimi për ti paraprire gabimeve të mundshme të vlerave numerike të ofertës. Detyrimi i plotësimi të formularit të ofertës me fjalë rrjedh nga rregullat e prokurimit dhe formati i dokumentave të tenderit. Për këtë KVO duhet të kishte qëndrim të unifikuar duke respektuar rregullat e prokurimit dhe dokumentat e tenderit.

Sa më sipër arsyetuar, gjykoj se ankesa e operatorit ekonomik “Shendelli” sh.p.k për skualifikimin e tij nga procedura prokurimit me Nr.REF-07104-02-08-2019, me objekt: “Rruga (Ibrahim Rugova+Mark Tirta+Mehdi Frasheri+Mit’hat Frasheri)” nuk qëndron, e për rrjedhojë nuk duhet pranuar, ndaj autoriteti kontraktor duhet të vazhdojë hapat e mëtejshme për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Anëtar

Merita Zeqaj